Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
  - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
  2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
    - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Shërbimeve</b>	<b>Njësia (Muaj)</b>	<b>Sasia (nr.vendroje ve)</b>	<b>Numri total i rojeve për vendroje</b>	<b>Çmimi Njësi / muaj</b>	<b>Oferta në total (neto)</b>
<b>1.</b>	Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Rajonin Tirane FSHU sh.a (Turni I-rë, nga ora 14 <sup>00</sup> - 16 <sup>00</sup> për 25 njësi nga e dita e hëne deri ditën e shtunë)	<b>(24)</b>	<b>(25)</b>	<b>(2)</b>	<b>(X)</b>	<b>(X)</b>
<b>2</b>	Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Rajonin Tirane FSHU sh.a (Turni II-të, nga ora 19 <sup>00</sup> - 21 <sup>00</sup> për 20 njësi, nga dita e hëne deri ditën e shtunë)	<b>(24)</b>	<b>(20)</b>	<b>(2)</b>	<b>(X)</b>	

<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>	
<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

### Sqarime:

1. Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor dhe nën ligjore në fuqi në lidhje me këtë shërbim që ka të bëjë me pagat, shtesat mbi pagë për turnet e II-ta, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për karburantin, shpenzimet për autorizimet e autoblivdave, shpenzimet administrative si dhe fitimi i shoqërisë, etj.
2. Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për 1 njësi me shërbim (Turni I-të, nga ora 14:00 - 16:00) dhe 1 njësi me shërbim (Turni II-të, nga ora 19:00 - 21:00) nga e Hëna deri të Shtunë, me koeficient (2) punonjës. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Preventiv të koston për 1 njësi në muaj për 2 orë shërbim transporti me 2 punonjës për Turni I-të

<b>Kosto Shërbim Shoqërimi ( nga e hëna ne te shtunë)</b>	
A. Paga baze mujore	
Paga baze ore	
Ore ne dite 2 (dy)	
Kosto per rruge per 2 punonjes	
Kosto shtese per Turni II/ore	
Sigurimet shoqerore	
Total shuma	
Shpenzime Mjet blind	
Fitim dhe shpenzime admin	
Total shuma	
<b>Totali A+B+C</b>	

Preventiv të kostos për 1 njësi në muaj për 2 orë shërbim transporti me 2 punonjës për Turni II<sup>të</sup>

<b>Kosto Shërbim Shoqerimi ( nga e hena ne te shtune)</b>	
A. Paga baze mujore	
Paga baze ore	
Ore ne dite 2 (dy)	
Kosto per rruge per 2 punonjes	
Kosto shtese per Turni II/ore	
Sigurimet shoqerore	
Total shuma	
Shpenzime Mjet blind	
Fitim dhe shpenzime admin	
Total shuma	
<b>Totali A+B+C</b>	

#### Analiza e kostos

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 113, datë 01.03.2023, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe Udhezimit Nr.130 datë 09.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomike ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek ( e kërkuar në dokumentat e tenderit ) .
- Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total.

**SHËNIM:** Operatorët Ekonomikë krahas Formularit të Ofertës dhe preventivit të publikuar në DST duhet të paraqesë edhe:

- Analizën e Çmimit me përlllogaritje konkrete aritmetike, në të cilën të jenë përfshirë të gjitha detyrimet ligjore si:

- Shpenzime për pagë bazë;
- Shtesë mbi pagë për turnin II;
- Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%,
- Fitim dhe Shpenzime administrative
- Shpenzime transporti + mjete blind

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

## **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

***“Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare për Njësinë e Koordinimit Tirane FSHU Sh.A”***

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Do të realizohet shërbimi i shoqërimit të vlerave monetare si më poshtë me Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit (Qendrat KNK) dhe Arkat e Pageses së Energjisë Elektrike objekte të FSHU sh.a.

**Ofruesi i Shërbimit SHPRSF duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme :**

- Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimit të vlerave monetare Nënkatëgoria 1.3.B me punonjës të armatosur do të bëhet siç parashikon Ligji Nr.75 datë 10.07.2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike", Ligji Nr.72/2014 "Për përdorimin e armëve të zjarrit" dhe Ligji Nr.74 datë 10.07.2014 "Për armet".

**Ne këte kuader:**

- Ofruesi duhet të prezantojë skemën e menaxhimit operacional, organizativ dhe kontrollit të shërbimit të sigurisë dhe shoqërimit të vlerave monetare gjatë transportit.
- Ofruesi duhet të paraqesë plane të vecanta për situata grabitjesh, sulmesh, rreziku emergjencash dhe fatkeqesish natyrore deri në vendosjen e kushteve normale përfshirë rregulloret që rregullojnë këte veprimtari.
- Ofruesi duhet të ofrojë menyrën dhe kohën e verifikimit dhe reagimit. Menyra e reagimit dhe e verifikimit duhet të jetë e detajuar dhe të përfshijë mjetet dhe punonjësit që do të angazhohen.
- Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-së duhet të jetë i përbërë nga punonjës të certifikuar në nënkategorinë 1.3.B sipas parashikimeve të Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike" botuar në Fletorën Zyrtare datë 09.03.2018.
- Keta punonjës duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse, uniforme dhe dokument identifikimi siç parashikohet në Ligjin Nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe Udhezimin Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.
- Me qëllim parandalimit të veprimeve kriminale, të gjithë punonjësit e shërbimit të SHPRSF-së duhet të zbatojnë me përpikëri rregullat si më poshtë:
  - Rregulloren e përbashkët të FSHU sh.a. dhe të SHPRSF-së të funksionimit të shërbimit në transportin e vlerave;
  - Librin e instruktazhit me pjesë nga aktet normative;
- Grupi i shoqërimit të vlerave monetare të SHPRSF-së duhet të shoqërojë vlerat monetare që i janë besuar dhe të sigurojë jetën e personelit gjatë transportit të vlerave monetare. Detyra e tij funksionale është shoqërimi i sigurtë i punonjësve (arketareve) nga Filialet e FSHU sh.a drejt filialeve të Bankave respektive sipas zgjedhjes së FSHU sh.a.

- Punonjesi i FSHU sh.a (arketari/rja) duhet te shoqerohet nga roje te armatosura.
- Ekskortat qe transportojne vlera monetare nuk duhet te ndalojne ne asnje rast gjate levizjes me ngarkese per transportin e vlerave monetare.
- Per transportin e vlerave monetare Operatori Ekonomik ofertues duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme sipas percaktimeve ligjore te Ligjit Nr.75 /2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike ", Ligjit Nr.72 /2014"Per perdorimin e armeve te zjarrit", Ligjit Nr.74 date 10.07.2014 "Per armet".
- Per transportin e vlerave monetare Operatori Ekonomik ofertues duhet te vere në dispozicion të punonjësve dhe mjetet speciale si: jelek antiplumb, hekura lidhes, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
- Shoqerimi duhet te kryhet nga mjetet e Operatorit Ekonomik. Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 12 automjete te blinduara ne emer te shoqerise ose me qera per transportin e vlerave monetare. Mjetet e blinduara duhet te jene te pajisura me dokumentacionin e kerkuar ne kriteret e vecanta te DST-se, (Kapaciteti Teknik). Mjeti duhet te jete i blinduar, i loguar ne gjendje te rregullt teknike dhe dokumentare qe te kryeje shoqerimin e vlerave monetare. Automjeti i blinduar duhet te jete i pajisur me autorizimin vjetor te Drejtorit te Pergjithshem te Policise se Shtetit ku te jene percaktuar niveli i blindimit, GPS, sistem vezhgimi, radio komunikimi etj;kerkesa keto te detyrueshme per cdo automjet te blinduar. Automjetet që transportojnë vlera monetare ndalohet që të vendosin në to dhe te përdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.
- Shoqerimi i vlerave monetare do te kryhet dy here ne dite me grafik sherbimi perkatesisht nga dita e hene - shtune; sipas vendndodhjes se Arkave apo Qendrave te KNK-ve te percaktuara ne tabelen e publikuar nga Autoriteti Kontraktor sipas shpërndarjes së objekteve dhe grafikut të ekzekutimit të përcaktuar në Shtojcën Nr.6 si dhe ne zbatim te plote te instruksioneve te personave pergjegjes te FSHU sh.a.
- Distanca qe duhet te mbulohet nga Shoqeria SHPRSF nga KNK/Arka deri ne filialin me te afert te bankes do te jete maksimumi 15 km (one way)ose 30 km (vice- versa).

Koha orare e shoqerimit te vlerave monetare do te jete :

- ✓Turni i pare do te kryhet nga Ora 14.00 - 16.00
- ✓Turni i dyte do te kryhet nga Ora 19:00 - 21:00

### **Punonjesi i sherbimit duhet te jete:**

- I certifikuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e funksionit.
- Te reflektuje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme.
- Gjate gjithë kohes se sherbimit duhet te respektoje rregullat e brendshme te FSHU sh.a.dhe te rregullores se perbashket dhe kontrates midis paleve.
- Të kërkojë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të objektit.
- **Punonjesi i sherbimit** duhet te jete i afte te reagoje dhe te veproje gjithmone ne perputhje me instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga FSHU sh.a.
- Të gjithë punonjësit e shërbimit "Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike", duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" të publikuar ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014 dhe Udhezimit

---

Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funksonimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike.

- Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike“, punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e sherbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPRSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjesit e sherbimit duhet te zbatojne nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike“ ku percaktohet qarte se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”*.
- **Drejtuesi Teknik i SHPSF-së** është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do te përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqërimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet te përcaktojë rregullat e funksionimit të SHPRSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe te përpilojë plandislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtje për situata emergjente. Ai do te jete përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do te siguroje bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje.
- **Qendra e Kontrollit** duhet te realizoje monitorimin me anë të sistemit të kamerave të cilësisë së lartë, gjurmimin dhe lokalizimin në kohë reale të automjeteve nëpërmjet sistemit GPS/GPRS, si dhe nepermjet komunikimit me pajisje ne perdorim:
  - o nëpërmjet telefonit celular (GSM);
  - o nëpërmjet telefonit fiks (Contact ID);
  - o (radio).
- Serveri bazë të jetë i pajisur me qendrën multifunksionale ku të ketë sistemin bazë të marrjes, përpunimit dhe ruajtjes së sinjaleve të alarmit, të marrjes dhe administrimit të të dhënave, në të gjitha rrugët e sigurimit, radio, GPS-GPRS, GPRS, ADSL.
- Qendra e Kontrollit me marrjen e njoftimit nga grupi i verifikimit te sinjaleve per ngjarje kriminale njofton sallen e komandimit te Komisarariatit te Policise ne juridiksion te te cilit ndodhet objekti,drejtuesin teknik dhe titullarin e SHPSF-se



## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Shërbimi i ruajtjes dhe shoqërimin të vlerave monetare për Njësine e Kordinimit Tirane FSHU Sh.A.”**

Nr	Zona	Pershkrimi i Qendres KNK	Total	
			Lloji I shërbimit	Turne
1	Tirane	KNK 1 kompleksi Delijorgji	12 ore	2
2		KNK 2 Kinostudio	12 ore	2
3		KNK 3 Ali Demi	12 ore	2
4		KNK 4 Qendra Kristal	12 ore	2
5		KNK 5 (Arka 19) BSH	12 ore	2
6		KNK 6 Don Bosko	12 ore	2
7		KNK 7 Pazari I Ri	12 ore	2
8		KNK rrugë e Elbasanit	8 ore	1
9		KNK Fresku	12 ore	2
10		KNK Unazë e Re	12 ore	2
11		KNK M Shyri	12 ore	2
12		KNK Kamez	12 ore	2
13		KNK Vore	12 ore	2
14		KNK Tirane Poligrafik	12 ore	2
15		KNK Tirane Paskuqan	8 ore	1
16		KNK Drejtoria Rajonale Tirane	12 ore	2
17		KNK Institut	8 ore	1
18		KNK Pallatet Cabej	12 ore	2
19		KNK Yzberisht	12 ore	2
20		KNK Fusha e Aviacionit	8 ore	1
21		Arka Kombinat	8 ore	1
22		Arka Laprake	12 ore	2
23		Arka Libri Univeristar	12 ore	2
24		Arka 21 Dhjetori	12 ore	2
25		Arka Sauk	12 ore	2
Total Turni I & Turni II				

#### **Afatet e ekzekutimit:**

Ekzekutimi i kontratës do të fillojë me nënshkrimin e kontratave, deri në përfundimin e afatit **24** (njëzet e katër) **mujo**r.

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

#### 1. Objekti dhe Qellimi i Sherbimit :

Ruajtja dhe shoqërimi vlerave monetare FSHU sh.a. Rajoni Tirane - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj.

Kontrata do të lidhet sipas afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

#### 2. Objektivat:

Ofertuesi i sherbimit do te siguroje ruajtjen dhe shoqerimin e vlerave monetare te Qendrave te KNK-ve dhe Arkave te Rajonit Tirane FSHU sh.a si dhe punonjesit / arketare gjate kohes qe ata jane duke performuar detyrat e tyre ne keto ambiente.

#### 3. Detyrat e Kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

- Cdo punonjes i sherbimit, Titullari i Subjektit te SHPSF-se, si dhe drejtuesi teknik duhet te kryejne me pergjegjesi te gjitha detyrat e percaktuara ne Ligjin Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" te publikuara ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014, si dhe ne Aktet Nenligjore te dala ne zbatim te tij.
- Ruajtja dhe shoqërimi i vlerave monetare të mbledhura nga KNK dhe Arkat do të bëhet çdo ditë nga e Hëna në të Shtunë nga vendndodhja e KNK dhe Arkave deri në bankat respektive me të cilat ka kontratë FSHU sh.a.
- Gjithashtu Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë ruajtjen fizike të punonjësve të KNK dhe arkave (arkëtarët) gjatë transportit të vlerave monetare deri në përfundim të dorezimit të këtyre vlerave pranë bankave respektive.

#### - Komunikimi mes paleve:

Komunikimi mes paleve do të përcaktohen në kontratën ndërmjet palëve. Komunikimi për urdhrat e transportit të vlerave monetare do të kryhet, në formë elektronike të enkriptuar ose te kodifikuar, i cili ndërrohet në mënyrë periodike për arsye sigurie nga persona të autorizuar të subjekteve që kërkojnë shërbim te Qendrat e Kontrollit të SHPSF-ve ose personi i autorizuar nga SHPSF-ja, duke bërë kodimin e objekteve të nisjes dhe mbërritjes. Urdhrat e lëvizjes për kryerjen e shërbimeve të transportit të vlerave mbahen në regjistër elektronik ose fizik nga Qendra e Kontrollit ose personi i autorizuar nga SHPSF-ja.

#### - Koha e Shërbimit:

Operatori Ekonomik duhet te ofroje sherbimin e kerkuar nga e hena ne te shtune perkatesisht ne:

- Turni i pare do te kryhet nga Ora 14.00 - 16.00

- 
- Turni i dyte do te kryhet nga Ora 19:00 - 21:00

### **Shperndarja**

Sipas tabelës së publikuar nga Autoriteti Kontraktor në këtë DST, Shtojca 6.

### **Vendi i kryerjes së shërbimeve:**

Arkët e pagesës së energjisë elektrike dhe Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit të Rajonit Tiranë / FSHU sh.a si dhe bankat respektive ku do të bëhet derdhja e vlerave monetare.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë :**

#### **2.1 Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike**

**2.1.1.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Licensën e Shoqërisë (te vlefshme) leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për ushtrimin e aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”, konform Ligjit Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligjin Nr.10137 dt. 11.05.2009, Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

**2.1.2.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatën e Titullarit të Subjektit të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vlefshme dhe t'i perkase ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”**, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike” dhe Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

**2.1.3.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **Çertifikatën e Drejtuesit Teknik të Shoqërisë e cila duhet të jetë e vlefshme dhe t'i perkase ushtrimit të aktivitetit të Kategorisë “1.3.B”**, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për Sherbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe Udhezimit Nr.130 dt. 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme “Për Funkcionimin e Sherbimit Privat të Sigurisë Fizike”.

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

**2.2.1** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuar të bilanceve të tre viteve të fundit 2020, 2021, 2022 të konfirmuara me vule pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmes “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të

---

regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” te ndryshuar; krahas bilanceve te paraqesin dhe raportet e audituesit te pavarur per bilancet e ketyre viteve te konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë per kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.2** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 200% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese Vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2023 (per NIPT-in kryesor dhe per NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**Sqarim:** përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

## **2.3 Kapaciteti Teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës limit te kontrates qe prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

---

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Licensat profesionale lidhur me shërbimin objekt kontrate:**

**2.3.2.** Operatori Ekonomik duhet të paraqese Autorizim Individual (*te vlefshem*) në emër të shoqërisë për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ne te cilen te kete fushe mbulimi ne zonat ku ndodhen objektet ne qytetin e Tiranës dhe ku do kryhet shërbimi.

**2.3.3.** Operatori Ekonomik duhet te disponoje nje Qender Kontrollit te Shërbimit (Salle Operative) me adrese te percaktuar sakte. Qendra e Kontrollit te jete e pajisur me sistem ndërlidhës, radiokomunikim dhe radioalarm, qe te bëjnë të mundur sigurimin e pandërprerë të radiondërlidhjes pranë çdo objekti. Bazuar ne nenin 22 te Ligjit Nr.75/2014 "Per Shërbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe ne Kreun VII, pika 5 te Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.130, datë 05.03.2018 "Për Funkcionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike"; Operatori Ekonomik te paraqese akt miratimi te vlefshem te leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane. Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te beje verifikimin ne terren te ekzistences se salles operative.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim performance leshuar ne jo me pare se tre muaj nga hapja e procedures nga Drejtoria e Policise se Tirane per kategorine e Licences 1.3B konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) te ndryshuar si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Ku duhet te jepet informacioni per disponimin e:

Qendra e kontrollit te Shërbimeve (salle Operative)

- Numrin e punonjësve të shërbimit të certifikuar ku operatori ekonomik te kete jo me pak se 24 punonjes te certifikuar.
- Operatori Ekonomik te disponoje jo me pak se 24 arme te Kategorise 1.3 B, Nenkategoria B1 dhe B4 per kryerjen e shërbimit te kerkuar, nga te cilat te kete 12 arme brezi nenkategoria B1 dhe 12 arme krahu nenkategoria B4, per kryerjen e shërbimit te kerkuar.
- Operatori Ekonomik te kete te dhena te plota ne lidhje me mjetet speciale ne administrim, te nevojshme per te kryer ruajtjen dhe shoqerimin e vlerave monetare, ne zbatim te Ligjit Nr. 75/2014 "Per Shërbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem "Per Funkcionimin e Shërbimit Privat te Sigurise Fizike". Mjetet speciale te perfshijne jo me pak se:
  - 24 radio nderlidhje
  - 24 shkopinj gome
  - 24 hekura lidhes
  - 24 jeleke antiplumb

Mjetet speciale mund te permbushen nga operoret ekonomik ose ne vertetimin e policise ose nepermjet paraqitjes se faturave tatimore qe vertetojne blerjen e tyre por edhe te jene marre me qira.

- Operatori Ekonomik te mos kete shkelje te konstatuara dhe mase administrative te marre nga Drejtoria Vendore e Policise Tirane per Subjektin, Titullar Subjekti dhe Drejtues Teknik nga data 1 janar 2022 e ne vazhdim.
  - Vertetimi te permbaje vleresim permbledhes per performancen e Operatorit Ekonomik.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve pjesëmarrës.

---

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim leshuar nga administrata tatimore per numrin e punonjesve te siguruar per 3 muajt e fundit duke marre si reference daten e hapjes se tenderit. Ky dokumentacion te paraqitet i shoqeruar me liste pagesat e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ku te jene te pasqyruar te pakten 26 punonjes (perfshire punonjesit e certifikuar dhe stafin drejtues) te paraqitura dhe te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme.

**Sqarim:** përmblidhja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmblidhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 12 automjete te blinduara ne emer te shoqerise ose me qera per transportin e vlerave monetare. Mjetet e blinduara duhet te jene te pajisura me:

- Autorizim te posacem vjetor nga Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit per perdorim te cdo mjeti te blinduar (te vlefshem), ku te jene percaktuar emri i shoqerise, te dhenat e mjetit dhe afati i vlefshmerise.
- Certificate pronesie.
- Leje qarkullimi nga Drejtoria e Transportit Rrugor per cdo mjet.
- Leje drejtimi te perdoruesit te mjetit te blinduar.
- Certificate e kontrollit teknik per secilin mjet (SGS).
- Siguracion te vlefshem.
- Vertetim per taksat e paguara.

